

PROJEKTI I ENERGJISË DIELLORE NË OSLOMEJ, REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Përmbledhje jo-teknike

Nëntor, 2018

Tabela e përmbajtjes

1	Hyrje	Error! Bookmark not defined.
2	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	Error! Bookmark not defined.
2.1	Përmbledhje e komponentëve kryesorë	4
2.2	Arsyetimi i projektit	Error! Bookmark not defined.
2.3	Alternativat e projektit	Error! Bookmark not defined.
3	PËRMBLEDHJE E KORNIZËS MJEDISORE DHE SOCIALE LIGJORE.....	5
3.1	Kërkesat nacionale për vlerësimin e ndikimit mjedisor	5
3.2	Kërkesat nacionale për angazhimin e palëve të interesit.....	6
4	ANGAZHIMI I PALËVE TË INTERESIT DHE SHPALOSJA I INFORMACIONEVE	6
4.1	Palët e interesit	Error! Bookmark not defined.
4.2	Angazhim i vazhdueshëm.....	Error! Bookmark not defined.
4.3	Shpalosja e informacioneve	Error! Bookmark not defined.
5	PËRMBLEDHJE E KUSHTEVE BAZË MJEDISORE DHE SOCIALE. NDIKIMET DHE MASAT E MITIGIMIT..	8
5.1	Përmbledhje e ndikimeve bazike, potenciale dhe mitigimi.....	8
5.1.1	Përdorimi i tokës dhe detyrimet	8
5.1.2	Toka	Error! Bookmark not defined.
5.1.3	Uji	Error! Bookmark not defined.
5.1.4	Cilësia e ajrit dhe emetimet në ajër.....	9
5.1.5	Zhurma dhe dridhjet.....	9
5.1.6	Peizazhi dhe ndikimet pamore	9
5.1.7	Biodiversiteti	9
5.1.8	Ndryshimet klimatike dhe të klimës	10
5.1.9	Menaxhimi i mbeturinave.....	Error! Bookmark not defined.
5.1.10	Shëndeti, mbrojtja dhe siguria e bashkësisë.....	10
5.1.11	Shëndeti dhe siguria në punë	10
5.1.12	Siguria në transport dhe komunikacion.....	Error! Bookmark not defined.
5.1.13	Mjedisi socio-ekonomik.....	Error! Bookmark not defined.
6	MENAXHIMI DHE MONITORIMI MJEDISOR DHE SOCIAL	11
7	INFORMACIONE TË TJERA DHE TË DHËNAT E KONTAKTIT	12

1 HYRJE

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“BERZH” ose “Banka”) shqyrton financimin e SH.A. Elektranat e Maqedonisë së Veriut (ESM ose Kompania) për zhvillimin e centralit fotovoltai (FV) prej 10 MW (Projekti) në Termocentralin ekzistues (TEC) Oslomej afër qytetit të Kërçovës, Republika e Maqedonisë së Veriut.

ESM-i është kompani shtetërore e energjisë elektrike që aktualisht ka tre termocentrale të mëdha me kapacitet të instaluar prej gjithsej 842 MW, si dhe me një numër të hidrocentraleve me gjithsej 554 MW kapacitet të instaluar dhe 38.6 MW në parkun me turbine të erës Bogdanci, projekti i parë i energjisë së erës në Republika e Maqedonisë së Veriut. Kompania aktualisht prodhon rreth 90% të prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike në Republika e Maqedonisë së Veriut.

Projekti do të zhvillohet në cepin e një djerrine të mëparshme, në kuadër të ish minierës së linjitet që do të sigurojë ripërdorim të dobishëm të tokës industriale aktualisht të pashfrytëzuar. Si i tillë, Projekti është kategorizuar si projekt “B” nga BERZH në përputhje me Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH (PMS) (2014) dhe për këtë arsye nuk është subjekt i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social; në mënyrë të ngjashme, sipas legjislacionit mjedisor të Maqedonisë, Projekti është në shkallë të vogël me potencial për ndikime të vogla mjedisore dhe sociale (M&S) dhe prandaj nuk është subjekt i Vlerësimit të ndikimit mjedisor. Megjithatë, në pajtueshmëri me Ligjin e Maqedonisë për Mjedisin kërkohet që të përgatitet një Raport të përpunuar mbi Vlerësimin e ndikimit në mjedis (jo një studim i plotë mbi Vlerësimin e ndikimit mjedisor) që përfshin një identifikim të kufizuar dhe vlerësim të ndikimeve dhe rreziqeve mjedisore dhe sociale. Raporti i përpunuar mbi Vlerësimin e ndikimit në mjedis për Projektin u zhvillua për Projektin dhe u miratua në Korrik të vitit 2018 nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Kjo përmbledhje jo-teknike në një gjuhë jo-teknike jep një pasqyrë të gjetjeve të Vlerësimit Mjedisor dhe Social të Projektit, duke përshkruar shkurtimisht Projektin, duke paraqitur gjetjet kyçe mbi M&S dhe duke përmbledhur potencialin e ndikimeve mjedisore dhe sociale, si dhe masat e mitigimit që duhet të zbatohen për të zvogëluar këto ndikime. Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit (SEP) që përshkruan aktivitetet e planifikuara angazhuese të palëve të interesit është zhvilluar për Projektin.

2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

ESM planifikon të zhvillojë një central FV 100MW, ngjitur me TEC Oslomej ekzistues, që ndodhet rreth 110 km në perëndim të Shkupit, në afërsi të fshatit Oslomej, në pjesën perëndimore të Maqedonisë. Qyteti më i afërt është Kërçova, i vendosur rreth 7 km në jug-perëndim (shiko Figurën 1 më poshtë). Projekti do të zhvillohet në cepin e një djerrine të mëparshme në kuadër të ish minierës së linjitet që do të sigurojë ripërdorim të dobishëm të tokës industriale aktualisht të pashfrytëzuar dhe energjia elektrike e prodhuar do të shitet direkt në rrjetin e afërt.

TEC Oslomej




Figura 1: Vendndodhja e projektit

Bashkësitë banuese më të afërta janë Oslomej (rreth 1 km në veri-perëndim të vendndodhjes), Zhubrino (rreth 2 km në veri-lindje), Sërbica (rreth 2.5 km në veri-lindje) dhe Shutovë (rreth 2 km në jug-lindje). Vendasja e përgjithshme e Projektit me lokacionet e bashkësive të afërta është paraqitur në Figurën 2 më poshtë.

Përmbledhje e komponentëve kryesorë

Centrali fotovoltaik diellor (FV) me 10MW përbëhet nga rreth 33,600 module FV modules, katër invertorë, njësi kontrolli, sensorë dhe pajisje të tjera mbështetëse. Centrali FV i propozuar do të shfrytëzojë linjën ekzistuese të transmetimit dhe nënstacionin ekzistues 35 kV i vendosur në vendin e minierës të Oslomejit rreth 350m në very të vendndodhjes së caktuar.

2.1 Arsyetimi i Projektit

Projekti është pjesë e strategjisë së ESM-it për të diversifikuar përzierjen e prodhimit nga qymyri dhe për të rritur pjesëmarrjen e prodhimit nga burimet e ripërtëritshme që do të sigurojnë energji të pastër në një vend apo rajon me mangësi serioze të kapaciteteve dhe nivele të larta të intensitetit të karbonit. Implementimi i projektit do të zmadhojë kapacitetin e instaluar të objekteve prodhuese të ESM-it për 10MW dhe prodhimin vjetor të energjisë elektrike prej 14,6GWh shtesë.

ESM-i do të kryejë investimin e pare në centralin FV si pjesë e strategjisë së zhvillimit të Kompanisë në mënyrë që të:

1. Dekarbonizojë dhe zhvillojë një portofol të projekteve për Burime të Ripërtëritshme të Energjisë;
2. Rrit prodhimin e energjisë elektrike na burimet e ripërtëritshme të energjisë;
3. Të sigurohet pajtueshmëria me direktivat e zbatueshme të BE-së.

Projekti do të mbështesë përpjekjet nacionale për të rritur pjesëmarrjen e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në prodhimin e përgjithshëm të energjisë elektrike.

2.2 Alternativat e Projektit

Vizitat në terren janë bërë në tre lokacionet e propozuara nga ESM-i për zhvillimin e centralit FV(Figura 2) për të kryer një vlerësim fillestar cilësor të potencialit teknik dhe çështjeve mjedisore dhe sociale si pjesë e përzgjedhjes së vendit më të përshtatshëm. Këto vizita në terren përfshijnë:

- Vend i djerrinës minerare;

3.2 Kërkesat nacionale për angazhimin e palëve të interesit

Projekti i përket kategorisë së aktiviteteve për të cilin duhet të përgatitet një Raport Elaborues mbi Vlerësimin e Ndikimeve Mjedisore. Për projekte të tilla të kategorive më të ulëta, For such lower category projects, deklarimi publik dhe konsultimi nuk është i detyrueshëm sipas legjislacionit nacional.

4 ANGAZHIMI I PALËVE TË INTERESIT DHE SHPALOSJA I INFORMACIONEVE

Kërkesat e Performancës të BERZH 10 (SHPALOSJA I informacioneve dhe Angazhimi i palëve të interesit), theksojnë rëndësinë e një angazhimi të hapur dhe transparent ndërmjet projektit, bashkësive lokale që ndikohen drejtpërdrejtë nga projekti dhe palët e tjera të interesit.

ESM-i ka zhvilluar një strategji korporative me përgjegjësi shoqërore dhe ka miratuar Deklaratën për Përgjegjësi Shoqërore. Sipas Deklaratës, ESM-i publikon thirrje publike për investimet e projektit. ESM-i ka informuar publikun për implementimin vijues të Projektit, kryesisht përmes deklaratave nga menaxheri i përgjithshëm i kompanisë dhe drejtorëve të sektorëve në masmedia.

Si pjesë e Vlerësimit Mjedisor dhe Social të Projektit është zhvilluar Planit i Angazhimit të Palëve të Interesit për të siguruar komunikim të qartë dhe të lehtë midis të gjithë palëve të interesit dhe palëve të prekura. Qëllimi i Planit të Angazhimit të Palëve të Interesit është që të rrisë angazhimin e palëve të interesit gjatë kohëzgjatjes së Projektit, dhe të kryejë angazhimin e palëve të interesit në pajtueshmëri me ligjet nacionale, si dhe Kërkesave të Performancës së BERZH.

Objektivi kryesor i Planit të Angazhimit të Palëve të Interesit është të përmirësojë dhe lehtësojë procesin e vendimmarrjes në lidhje me Projektin dhe të krijojë mundësi për përfshirje aktive të të gjithë palëve të interesit në kohë duke dhënë mendimet dhe shqetësimet e tyre që mund të ndikojnë në implementimin e Projektit. Gjithashtu përcakton se çfarë informacioni do t'u zbulohet palëve të interesit dhe përcakton se si palët e interesit mund të paraqesin ankesë, shqetësim apo pyetje në lidhje me Projektin.

4.1 Palët e interesit

Procesi i përfshirjes së ESM-it do të përdoret për të marrë komente dhe sugjerime për zhvillimin e Projektit. Palët e identifikuar të interesit përfshijnë:

Bashkësia (palët e prekura);

Të punësuarit dhe punëtorë të papunësuar (palët e interesit);

Autoritetet përkatëse qeveritare, ministritë dhe institucionet publike (palët e interesit);

Organizatat jo-qeveritare dhe shoqëritë profesionale (palët e interesit);

Autoritetet lokale dhe regionale (palët e interesit); dhe

Institucionet financiare dhe kompanitë private (palët e interesit).

4.2 Angazhim i vazhdueshëm

ESM-i ka krijuar mekanizma për komunikim me publikun. Kompania ka një faqen e internetit të azhuruar rregullisht ku shpall lajme, njoftime dhe raporte për projektet aktuale. ESM-i ka profile në rrjetet sociale përmes të cilave komunikon me publikun, përkrah konferencave për shtyp dhe njoftimeve zyrtare për shtyp.

Edhe pse ligji aktual i Maqedonisë nuk e kërkon këtë, ESM-i vullnetarisht do të shpalosë versionin më të fundit të Raportit Elaborues mbi Vlerësimin e Ndikimeve Mjedisore për Projektin në faqen e internetit të Kompanisë. ESM-i

do të bëjë konsultime publike dhe shpërndarjen e informacionit sipas Planit të Angazhimit të Palëve të Interesit që do të reflektojë çështjet/ndikimet kryesore mejdimore dhe shoqërore (p.sh. zhurma dhe siguria në komunikacionit gjatë fazës së ndërtimit, mundësitë për punësim, siguria e bashkësisë, ndikimet pamore, etj.) në Projekt në komunën e Kërçovës.

ESM-i do të caktojë dhe do të mbajë të paktën një takim publik konsultativ në Kërçovë pas shpalesjes së dokumentave të lartë përmendura. ESM-i do të informojë palët e interesit për datën, kohën dhe vendin e saktë ku do të mbahet takimi, së paku 2 javë përpara takimit, përmes shpalesjes në faqet e internetit të ESM-it, medimeve lokale (gazeta, portale online të lajmeve) dhe tabelave të shpalljeve të komunës së Kërçovës. Njoftimi për takimin public gjithashtu do të postohet edhe në bashkësitë lokale, me qëllim që të targetohen në mënyrë specifike banorët lokalë.

Gjatë kohëzgjatjes së Projektit, palët e interesit do të kenë mundësi që të reagojnë dhe të marrin përgjigje për pyetjet dhe komentet. Procedura formale e ankesave (gjithashtu e njohur si Procedura e Ankesave) do të jetë gjithashtu një vend për të siguruar që ankesat do të trajtohen në kohë dhe në mënyrë konsistente. Do të informojë palët e interesit për mekanizmin e ankesave duke njoftuar për mundësinë e regjistrimit të ankesave, personat e kontaktit, funksionet e tij dhe procedurat për paraqitjen e ankesës në zonat e prekura dhe për marrjen e përgjigjes. Formulari i Projektit për Ankesa dhe Fletushka e Ankesave Publike do të vendosen në faqen e internetit të ESM-it dhe gjithashtu do të jenë të disponueshme edhe në kopje të shtypura në hapësirat e ESM-it dhe bashkësitë që janë përreth vendndodhjes së centralit dhe komunën e Kërçovës.

4.3 Shpalesja e informacioneve

Kompania synon që të shpalesë paketën e mëposhtme të Projektit:

- Raportin Elaborues për Vlerësimin e Ndikimeve Mjedisore i përpunuar në mars, 2018;
- Planin e Angazhimit të Palëve të Interesit;
- Formularin e Projektit për Ankesa dhe Fletushkën e Ankesave Publike (shiko Shtojcën A); dhe
- Përmbledhjen jo-teknike (NTS).

Paketa e shpalesjes do të jetë publike në gjuhën angleze dhe maqedone, dhe Përmbledhja jo-teknike dhe Formulari i Projektit për Ankesa dhe Fleturshka e Ankesave Publike do të jenë publike në tre gjuhët zyrtare të komunës së Kërçovës (maqedonisht, shqip dhe turqisht) menjëherë pas përfundimit të tij, në faqen e internetit të ESM-it: <http://www.elem.com.mk/>

Dokumentet do të shpallen në faqen e internetit 30 ditë para mbajtjes së takimit public dhe do të qëndrojnë publike gjatë gjithë kohëzgjatjes së Projektit. Linku i faqes së internetit të ESME-it do të sigurohet sëbashku me dokumentet e tjera.

Gjithashtu, kopje të shtypura të dokumenteve do të jenë të disponueshme edhe në këto lokacione:

- Zyrat e ESM-it në Shkup (11 Tetori Rr. 9, Shkup 1000)
- Komuna e Kërçovës (Boris Kidriç Nr. 1 6250 Kërçovë)
- Qendra për Zhvillim të Rajonit Planor Jug-Perëndimor (Rr. Partizanska, Kutia postale 27,6330 Strugë)
- Zyrat e bashkësive në vendbanimet: Zhubrinë, Sërbica, Oslomej dhe Shutovë (së paku Përmbledhja jo-teknike e Projektit, Fletushka informative dhe Formularët për ankesa)

5 PËRMBLEDHJE E KUSHTEVE BAZË MJEDISORE DHE SOCIALE. NDIKIMET DHE MASAT E MITIGIMIT

5.1 Përmbledhje e ndikimeve bazike, potenciale dhe mitigimi

Përmbledhje e ndikimeve të identifikuar dhe masave të planifikuara për mitigimin e këtyre ndikimeve gjatë fazës së ndërtimit dhe punimit janë të dhëna më poshtë për çdo çështje kyçe. Kushtet bazike janë marrë nga vizitat në terren që janë kryer dhe informacionet ekzisutese të disponueshme.

5.1.1 Përdorimi i tokës dhe detyrimet

Zona përreth, përfshirë edhe Vendin që është përdorur si zonë e minierës së linjtit dhe si central elektrik me qymyr që nga viti 1980, duke përfshirë edhe ruajtjen, transferimin dhe trajtimin e materialeve jo – të rrezikshme dhe të rrezikshme. Vendi është përdorur si djerrinë që nga fillimi i vitit 1980 deri në fillime e viteve 2000. Djerrina buron nga aktivitetet e afërta të minierës së linjtit për TEC Oslomej. Vendi është në pronësi të TEC Oslomej dhe aktualisht është zonuar si tokë industriale.

Sipas ligjit aktual të Maqedonisë, TEC Oslomej si mbajtës i lincencës së minierave është përgjegjës për çdo ndotje të tokës dhe ujërave nëntokësorë të mëparshme apo aktuale që ndodhen në Vendin e projektit. Megjithatë, TEC Oslomej mund të lirohet nga detyrimet e saj sa i përket Vëndit nëse merren masa adekuate të rivendosjes në Vend. Kjo lejohet me ligjin aktual për minierat, nëse hartohet Plani për Menaxhimin e Mbeturinave mbulon mbyllje dhe rivendosje të çfarëdo lloj zone për magazinimin e mbeturinave. ESM-i ka kërkuar konfirmim me shkrim nga autoritetet përkatëse që të sqarojnë kërkesat e rivendosjes së minierës dhe nevojat e dokumentacionit (p.sh. nëse kërkohet plan për menaxhimin e mbeturinave). Varësisht nga përgjigja Kompania ka konfirmuar se do të zhvillojë Plan për Menaxhimin e Mbeturinave për minierën Oslomej. Plani gjithashtu do të mbulojë edhe centralin FV të propozuar dhe do të sigurojë masa rehabilituese që do të ndërmerren në Vend.

Gjatë vizitës në terren, Rambolli nuk vërejti ndonjë shenjë të dukshme të kontaminimit aktuale apo të mëparshme. Nuk është identifikuar asnjë ndotje e konsiderueshme në lokacionin e zgjedhur të FV që do të kërkonte veprim të mëtejshëm.

Nuk do të ketë marrje të tokës së pjesë e Projektit. Nuk ka asnjë çështje të lidhur me praninë apo përdorimin joformal të tokës bredna apo në afërsi të Lokacionit.

Përdorimi aktual i Lokacionit nuk konsiderohet të paraqesë rrezik të konsiderueshëm sa i përket ndotjes së tokës. Megjithatë, ndotja e lokalizuar në lokacion nuk mund të përjashtohen. Në këtë rast, ndikimet e mundshme negative konsiderohen të jenë **lokale** dhe **të parëndësishme**. Ripërdorimi i pritshëm i dobishëm i ish tokës industrial konsiderohet të ketë ndikim pozitiv. Pogrami i riparimit do të zhvillohet për t'i adresuar ndikimet e identifikuar nëse haset në ndotje.

5.1.2 Toka

Cilësia e tokës në Lokacionin nuk është e njohur, duke marrë parasysh mungesën e hetimeve mjedisore në lokacion. Gjatë vizitës në terren, e gjithë zona e lokacionit ishte e paprekur dhe e mbuluar me vegjetacion. Toka në të gjithë vendin e lokacionit është vërejtur të jetë kryesisht argjilore duke shtuar materialin shkëmbor.

Aktivitetet e Projektit do të kenë **ndikim të moderuar negative në nivel lokal** mbi token përgjatë kohëzgjatjes së Projektit. Duhet të sigurohet një plan gjithëpërfshirës i menaxhimit të drenazhimit që përfshin përshkrim të detajuar të rregullimit të përkohshëm të drenazhimit, kontrollimit të erozionit dhe masave të kapjes së baltës dhe masa të tjera trajtuese të nevojshme për të qenë në përputhje me legjislacionin nacional dhe GIIP.

5.1.3 Uji

Sipërfaqja ujore më madhe e afërt është Liqeni Oslomejqë ndodhet rreth 3 km në jug të Lokacionit. Pranë Lokacionit në juglindje ka pellgje të vogla dhe kënetë. Për shkak të terrenit të ngritur, Lokacioni nuk është i prirur për përmbajtje. Brenda 500 m të Lokacionit nuk ka asnjë burim nxjerrës i ujërave nëntokësore.

Projekti mund të ketë ndikime **të konsiderueshme negative** mbi ujërat sipërfaqësore si rezultat i largimit të dy sipërfaqeve ujore për zhvillimin e centralit FV. Nuk pritët që projekti të konsumojë vëllim të madh të ujit apo të prodhojë vëllim të konsiderueshëm të ujërave të zeza gjatë fazës së funksionimit. Për të minimizuar ndikimet mbi sipërfaqet ujore në Lokacionin, duhet të bëhen përpjekje që sipërfaqja e madhe ujore të rruhet dhe të shmanget nga punët (ku është praktike) e ndërtimit të centralit solar FV.

5.1.4 Cilësia e ajrit dhe Emetimet në ajër

Lokacioni i Projektit është i pazhvilluar dhe aktualisht nuk ka burime stacionare të emetimeve në ajër. Emetimet kryesore në ajër që gjenerohen në Lokacion përfshijnë kryesisht emetimet e lëshuara nga automjetet, përfshirë edhe lëshime të emetimeve nga pluhuri që shkaktohen nga lëvizja e automjeteve mbi token e pashtuar.

Emetimet në ajër **të parëndësishme dhe lokale** priten të jenë gjatë fazës së ndërtimit. Projekti pritët të gjenerojë vëllime të papërfillshme të emetimeve në ajër gjatë fazës së funksionimit.

5.1.5 Zhurma dhe Dridhjet

Zhurma aktuale në Lokacion gjenerohet kryesisht nga makineritë e ndërtimit që kryejnë veprimet e nivelimit. Duke pasur parasysh shkallën e punimeve aktuale të nivelimit dhe largësinë ndaj bashkësive të afërta (mbi 1 km nga Lokacioni), nivelet aktuale të zhurmës nuk janë të konsiderueshme.

Ndikimet e zhurmës në fazën e ndërtimit kanë mundësi për të qenë **lokale dhe të parëndësishme**. Nuk pritët që të ketë ndikime të zhurmës apo vibrimit gjatë punimeve në Projekt. Mbulesa e propozuar kundër llamburit në panelet FV edhe më tej do të zvogëlojë ndikimet e mundshme. Sipas mundësisë, orientimi i panelëve duhet të konsiderojë mundësinë për reflektim drejt vendbanimeve.

5.1.6 Peizazhi dhe ndikimet pamore

Vendbanimet në këndvështrimin e zhvillimit të propozuar në përgjithësi janë të vendosura në shpatet kodrinore në very lindje dhe jug të Lokacionit, në largësi më të madhe se 2km. Pamjet nga këto vendbanime aktualisht shtrihen përgjatë një peizazhi që është në ndikim të madh nga veprimi njerëzor, siç është TEC Oslomej sëbashku me djerrinën/pellgje me hi dhe të prishura.

Zhvillimi i centralit FV nuk ka gjasa të ndikojë në cilësinë apo karakterin e pamjes nga vendbanimet përreth; megjithatë, reflektimi i diellit mund të shkaktojë ndryshim të dukshëm në pikëpamje gjatë disa kohëve të caktuara të ditës. Duke pasur parasysh distancën e Lokacionit nga receptorët, kjo konsiderohet të jetë **e parëndësishme**.

5.1.7 Biodiversiteti

Lokacioni nuk konsiderohet të jetë mjedis kritik për cilëndo specie. Asnjë nga llojet e habitateve apo tiparet e identifikuar nuk konsiderohen të përbëjnë tipar prioritar të biodiversitetit. Ekzistojnë dy zona ligatinore, përfshirë një sipërfaqe të madhe ujore e mbuluar pjesërisht me vegetacion të lartë në zhvillim, me thellësi të sipërfaqes ujore rreth 1m. Lloji dominues i habitatit në Lokacionin është një kullotë e pasur me lule të egra. Ka edhe një zonë të madhe dhe një numër të zonave më të vogla pyjore. Zona pyjore dominohet nga specie të shelgut dhe plepit. Lokacioni mbështet një llojllojshmëri të llojeve të habitateve që janë krijuar në mënyrë natyrale që nga depozitimi i materialit të djerrinës. Ekziston një specie kritike instektesh e rrezikuar (flutura *Pseudochazara cingovski*) dhe dy

specie insektesh të rrezikuara (bulkthi *Bradyporus macrogaster* dhe *Dasypoda frieseana* (specie të bletave të paemëruara)), që njihen të jenë të pranishme në afërsi të Lokacionit por nuk janë hasur në Lokacion gjatë kohës së vizitës në terren.

Largimi i habitateve të vegjetuara do të ketë mundësi për ndikime negative me rëndësi vetëm në nivel **lokal**. Për fazën e ndërtimit – shmangia e Tipareve Kyçe të Habitave, zona e ndërtimit duhet të minimizohet sa më shumë që është e mundur duke mundësuar që zonat e habitateve që janë jashtë të rruhen dhe zonat që përdoren vetëm përkohësisht të rivendosen. Në fazën operuese (punuese) – rritja e tepruar e vegjetacionit/barërat duhet të largohen në mënyrë manual/mekanike dhe jo me anë të herbicidëve, dhe të gjitha zonat e kullotave të ruajtura/rivendosura duhet të priten një here në vit dhe mbetjet e prera të largohen.

5.1.8 Ndryshimet klimatike dhe të klimës

Emetime të gazrave serrë direkte të Projektit do të jenë **papërfillshme** dhe në çdo rast nuk pritet të jenë më shumë se 25,000 ton të CO₂-ekuivalent në vit. Projekti pritet të zhvendosë përafërsisht 12,500 ton të CO₂ në vit dhe kjo do të gjenerohet nga gjenerimi i energjisë elektrike nga karburantët fosil: kjo konsiderohet si ndikim **pozitiv** në nivel rajonal.

5.1.9 Menaxhimi i mbeturinave

Nuk ekziston deponim apo trajtim të mbeturinave (përveç deponimit të materialit të djerrinës që konsiderohet si mbetje e parrezikshme inerte) aktualisht në Lokacion. Mbeturinat që prodhohen aktualisht nga burime të Lokacionit nga makineritë ndërtuese dhe pastrimit të vegjetacionit trajtohen jashtë, në TEC Oslloj.

Vlerësimi i mbeturinave merr parasyshë ndikimet e mundshme që dalin nga menaxhimi i mbeturinave që prodhohen nga Projekti. Mbeturinat e prodhuara nga Projekti konsiderohet të jenë **të parëndësishme dhe lokale**, duke pasur parasyshë llojin dhe vëllimin e mbeturinave të krijuara. Gjatë fazës së operimit, mbeturinat priten të prodhohen nga fundi i kohëzgjatjes nga deponimi i mbetjeve të panelëve FV dhe pjesëve të dëmtuara/shpenzuara.

5.1.10 Shëndeti, mbrojtja dhe siguria e bashkësisë

Aktualisht nuk ka gardh të sigorisë përreth Lokacionit. Udhëheqësia e TEC Oslloj raportoi se gjatë viteve të fundit ka pasur zero incidente të hyrjes pa leje. Nuk është vërejtur asnjë person i paautorizuar apo kafshë gjatë vizitës në terren.

Projekti ka mundësi për ndikim **të konsiderueshëm negative** në shëndetin dhe sigurinë e bashkësisë përmes potencialit për goditje elektrike apo ndikime të harkut elektrik, përveç nëse janë instaluar gardhe sigurie adekuate dhe hyrje kontrolluese. Duhet të instalohen gardh i përshtatshëm i sigorisë dhe hyrjet kontrolluese për lokacionet FV.

5.1.11 Shëndeti dhe siguria e punonjësit në punë

Gjatë vizitës në terren u vërejtën punime të vogla niveluese. Këto punime janë ndërmarrë nga personeli i TEC Oslloj duke përdorur makinerinë ndërtimore të TEC. Projekti do të funksionojë sipas sistemit aktual të menaxhimit SH&S të ESM-it. Kompania merr përsipër mbikqyrje të kufizuar mjedisore, shëndetësore dhe të sigorisë për aktivitetet e kontraktorit.

Vlerësimi i shëndetit dhe sigorisë në punë të punonjësve merr parasyshë rreziqet e mundshme të shëndetit dhe sigorisë në punë për kontraktuesit/personelin e nënkontraktorit. Projekti ka potencial për rreziqe **negative të konsiderueshme** të sigorisë dhe shëndetit në punë për kontraktorin/personelin nënkontraktues, sidomos në fazën

e ndërtimit. Masat e mitigimit për të rritur sigurinë e punonjësve përfshijnë zhvillimin e Planit të Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit për fazën e ndërtimit bazuar në GIP dhe rritja e mbikqyrjes së kontraktorëve. Zgjeroni mekanizëm ankimi për punonjësit për personelin e kontraktorit dhe nënkontraktorit.

5.1.12 Siguria në transport dhe komunikacion

Dispozitat e sigurisë në zonën përreth Lokacionit, veçanërisht rruga e qasjes në Lokacion, janë të dobëta dhe kanë nevojë për përmirësim. ESM-i është i vetëdijshëm për këtë dhe planifikon që t'iu adresohet këtyre çështjeve, përfshirë qasjen në Lokacion, vendkalimet/rrugët e përcaktuara dhe shenjat rrugore.

Nuk ka vende të ndjeshme (p.sh shkolla, spitale, etj) të vendosura në afërsi të Lokacionit. Aq sa është në dijeni Kompania, nuk ka plane të ardhshme për ndërtimin e vendeve të tilla të ndjeshme në afërsi të zonës së Projektit.

Pritshmëritë janë që Projekti të përmirësojë rrjetin lokal të rrugëve Brenda lokacionit të TEC Oslomej që do të ketë ndikim **pozitiv** të natyrës **lokale**. Gjatë fazës së ndërtimit, mund të ketë mundësi për ndikim **të konsiderueshëm negative** të natyrës **lokale** të shkaktuar nga automjetet dhe makineritë e ndërtimit. Për sigurinë e transportit dhe komunikacionit në Lokacion, masat më të përshtatshme të mitigimit që duhet të zbatohen përfshijnë dispozitën e trajnimit adekuat për personelin e Projektit mbi drejtimin e automjetit dhe sigurinë e automjetit, identifikimi i masave të sigurisë rrugore dhe inkorporimi i këtyre komponentëve në aspektet ndërlidhëse të hartimit të Projektit, aty ku mund të aplikohen. Do të kryhet Vlerësim i Rrezikut në Komunikacion për të identifikuar, vlerësuar dhe monitoruar rreziqet e mundshme të sigurisë rrugore dhe në komunikacion për bashkësitë që mund të preken gjatë kohëzgjatjes së Projektit. Do të zhvillohet edhe Plan i Menaxhimit të Komunikacionit për fazën e ndërtimit.

5.1.13 Mjedisi socio-ekonomik

Në afërsi të Lokacionit nuk ka bashkësi banuese. Tre bashkësitë më të afërta banuese, Zhubrino (rreth 2 km verilindje), Sërbica (rreth 2.5 km verilindje) dhe Shutovë (rreth 2 km juglindje) janë të vendosura në kodra përreth me pamje nga Lokacioni në very dhe jug dhe përfaqësojnë vend të përhershëm banimi me kopshte të mëdha.

Ekonomia lokale është kryesisht bujqësore. Në bazë të Regjistrimit të Bujqësisë në vitin 2007, komuna e Kërçovës ka pasur 5,649 posedime individuale bujqësore që kanë shfrytëzuar 81,7% të tokës së përgjithshme bujqësore në kuadër të komunës. Mbarështimi i gjedhëve është lloji kryesor i aktiviteteve bujqësore. Sektorë tjerë të rëndësishëm janë shërbimet (duke përfshirë shitje me pakicë, hoteleri, restorante etj.) dhe sektorët e ushqimit dhe tekstit.

Si pjesa tjetër e Maqedonisë, edhe Kërçova ka kaluar një proces të dhimbshëm të deindustrializimit. Një e katërta e ndërmarrjeve të epokës socialiste janë likuiduar, duke zhdukur më shumë se gjysmën e vendeve të punës në industri në fillim të viteve 2000. Sektori privat është kryesisht një fushë e dyqaneve dhe kafeneve të drejtuara familjarisht, me sektor të vogël ndërtimi shumë të varur nga kontratat e punëve publike.

Nuk ka pasur të dhëna publike për punësimin në rajon gjatë kohëve të fundit.

Pritshmëritë janë që Projekti të punësojë një pjesë të stafit aktual të TEC Oslomej (rreth 30 punëtorë) në fazën e ndërtimit. Ky konsiderohet si ndikim **pozitiv** i natyrës **regjionale**.

6 MENAXHIMI DHE MONITORIMI MJEDISOR DHE SOCIAL

Monitorimi mjedisor dhe social do të zbatohet gjatë fazës së ndërtimit dhe funksionimit të Projektit. Disa nga masat dhe aktivitetet e monitorimit që duhet të zbatohen gjatë fazës së ndërtimit dhe monitorimit janë:

- *Përdorimi i tokës dhe detyrimet* – Monitorim gjatë ndërtimit për zbulim të çfarëdo kontamini të panjohur dhe menaxhim i duhur i çdo materiali të gjetur.

- Toka – Monitorimi eriozionit të tokës dhe përfshirja në planin menaxhues të drenazhimit. Kjo do të përfshinte, por nuk do të kufozohej në monitorimin e zonave të pastërta për probleme erozioni pas rreshjeve, monitorim i aktiviteteve të pastrimit të vegjetacionit afër zonave të ndjeshme (p.sh. kënetë), etj.
- Biodiversiteti – Përfundimi i sondazhit vjetor të vegjetacionit për habitatet e kullotave të restauruara gjatë muajit korrik për tre vitet e para pas rivendosjes në mënyrë që të monitorohet efektiviteti i rivendosjes/rritjes së habitatit.
- Shëndeti, mbrojtja dhe siguria e bashkësisë - Identikimi, vlerësimi dhe monitorimi i rreziqeve të mundshme rrugore dhe të komunikacionit në bashkësitë që mund të preken gjatë kohëzgjatjes së Projektit.
- Shëndeti dhe siguria e punonjësit në punë – rritja e mbikqyrjes së kontraktorëve. Monitorimi i performances së shëndetit dhe sigurisë në punë përmes metrikave të përcaktuara bashkarisht (LTIFT, etj.) duhet të kryhet me qëllim që të ndërmerren masa në kohë që ë adresohen çështjet dhe mangësitë (gjithashtu në fazën e ndërtimit të përfshihet Plani i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë).
- Siguria rrugore dhe në komunikacion – Instalimi i një gardhi adekuat të sigurisë dhe hyrje kontrolluese për Lokacionin.
- Praktika të Angazhimit të Palëve të Interesit – Parametrat përkatës monitories duhet të përfshijnë aktivitetet angazhuese të mbajtura; çështjet dhe shqetësimet e ngritura dhe të përgjigjura; numri i llojit të ankesave dhe afati kohor për përgjigje.

Të gjitha ndikimet negative pas mitigimit pritet të jenë të papërfillshme.

7 INFORMACIONE TË TJERA DHE TË DHËNAT E KONTAKTIT

Paketa e shpalosjes do të publikohet në gjuhën maqedonase dhe shqipe (si dhe në gjuhën angleze aty ku është e mundur) menjëherë pas disponueshmërisë së saj, në faqen e internetit të Kompanisë ESM www.elem.com.mk.

Çfarëdo komente apo shqetësime mund të drejtohen në Njësinë e Informimit Publik në formë verbale (personalisht ose përmes telefonit) ose në formë të shkruar duke plotësuar Formularin e Projektit për Ankesa (të dorëzohet personalisht, përmes postës, faksit ose e-mail në adresën/numrin e dhënë më poshtë) pa pagesë. Ankesat në do kohë mund të dorëzohen në mënyrë anonime ose sipas preferencës, edhe pa përdorimin e formularit.

Në çdo kohë, ankuesit mund të kërkojnë rrugë të tjera ligjore në pajtueshmëri me kornizën ligjore të IRJ Maqedonisë, duke përfshirë edhe apelin zyrtar gjyqësor.

Detajet e kontaktit për Projektin janë:

Kontakt informimi për pyetje dhe ankesa:
 Vëmendje: Zyra e Menaxherit të përgjithshëm
 ASH Kompania “Elektratat e Maqedonisë së Veriut”
 Adresa: Rr. 11.Tetori 9, 1000 Shkup
 Tel: + 389 2 3149 121
 E-mail: contact@elem.com.mk